



**REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO**  
**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Dep.	2-D/DPK	Dokument
Dep.		
Dep.		
Nr. Ifaq.		
Broj stranica	02	
Nr. pages		
		PRISHTINA
		06.02.2015
		Nr. Prot.
		Bi. Prot.
		Prot No.
		Data
		Datum
		Date



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 05.02.2015, mori:

### V E N D I M

**I. Mbylljet rasti me nr. AKK-03-3934/14, për znj. Arta Rama - Hajrizi, Gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, për shkak se zyrtarja e lartë publike ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtimin e Funksionit Publik për zyrtaren e lartë, znj. Arta Rama - Hajrizi, Gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtimin e Funksionit Publik.

Zyrtarja e lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimit të kësaj shkrese, kemi organizuar një takim me zyrtaren e lartë, me këtë rast ajo është bindur me fakte për gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Gjatë këtij takimi zyrtarja e lartë znj. Rama – Hajrizi, ka deklaruar se ka kohë që nuk e ushtron funksionin në atë biznes privat dhe se ajo ka mbetur vetëm e regjistruar në letër (informata të biznesit), sepse nuk janë freskuar ndryshimet që realisht kanë ndodhë.'

Zyrtarja e lartë znj. Rama - Hajrizi, ka pranuar rekomandimin e Agjencisë, për të bërë ndryshimet e nevojshme në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve, për të shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit.

Duke parë se procesi i ndryshimeve të kërkuar po zgjatë Agjencia i ka bërë shkresën e dytë sipas procedurës ligjore që quhet "njoftimi paralajmërues", me të cilin zyrtares së lartë i është bërë e qartë se duhet të heq dorë nga funksioni i të qenurit person i autorizuar në biznesin privat, përndryshe do të pasojnë masat sankzionuese të parapara me ligj.

Ndërkojë, Agjencia Kundër Korrupsionit ka pranuar një shkresë zyrtare të lëshuar nga Agjencion i për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03-02/223/15) në të cilën vërtetohet se zyrtarja e lartë znj. Arta Rama – Hajrizi është larguar nga funksioni i personit të autorizuar në biznesin privat Sh.P.K “Auk Research Center”.

**II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.**

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit  
